

**GJYKATA E QARKUT
GJILAN**

30 shtator 2011

AC.nr.35/2011

GJYKATA E QARKUT E GJILANIT në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Rositza BUZOVA, si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtari Kosovar Muhamet REXHA dhe Gjyqtari Kosovar Abdullah AHMETI, si anëtarë të trupit gjykues,

Në lëndën civile të paditësit ILMI BRAHIMI nga GJILANI kundër të paditurës Komunës së GJILANIT, në padinë për konfirmim të pronësisë me arsyetim ligjor, Neni 254, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 532, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-006 në Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/2008) tash e tutje “LPK”),

Duke vendosur në ankesën e ILMI BRAHIMIT kundër Aktgjykimit C.nr.559/2002 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 6 tetor 2010 për refuzim të padisë së mësipërme në seancë të shkallës së dytë për shqyrtim të drejtpërdrejtë të lëndës sipas Nenin 190, paragrafët 2 dhe 4 të LPK, të mbajtur më datën 30 shtator 2011,

Me anë të kësaj sipas Nenit 195, paragrafi 1, pika d) në lidhje me Nenin 200 të LPK merr si në vijim

AKTGJYKIM

Ankesa e ILMI BRAHIMIT nga GJILANI **REFUZOHET** si e pabazuar dhe aktgjykimi C.nr.559/2002 i Gjykatës Komunale të GJILANIT, i datës 6 tetor 2010 VERTETOJ.

ARSYETIM

I. Historiati Procedural

1. Me aktgjykimin C.nr.559/2002 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 6 tetor 2010 ishte refuzuar si e pabazuar e kërkesë padia e ILMI BRAHIMIT nga GJILANI kundër Komunës së GJILANIT për të vërtetuar pronësisë e tij në ngastrën katastrale nr. 918, në vendin e quajtur “ POPOVICA” me kulturë – arë e klasit të 4, me sipërfaqe prej 00.32.20 ha, e regjistruar në Listën Poseduese nr. 1750, Zona Katastrale (ZK) GJILAN në emër të Komunës së GJILANIT, dhe të obligoj të paditurin të njoh këtë të drejtë. Sipas Nenit 452, paragrafi 2 i LPK gjithashtu ishte vendosur që secila palët t’ i bartë vetë shpenzimet e procedurës.

2. Më datën 30 nëntor 2011, është paraqitur ankesë nga ILMI BRAHIMI kundër këtij aktgjykimi duke e refuzuar atë në tërësi *për shkelje thelbësore të dispozitave të*

procedurës kontestimore sipas Nenit 182 të LPK, vërtetim i gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas Nenit 183 të LPK dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale sipas Nenit 184 të LPK. Kërkesa e paditësit sikurse është plotësuar në seancë sipas Nenit 190, paragrafët 2 dhe 4 të LPK është gjykata e shkallës së dytë për të prishë aktgjykimin C.nr.559/2002 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 6 tetor 2010 me kthim të lëndës në gjykatës e shkallës së parë për rigjykim apo të modifikoj atë me aprovim të padisë.

3. Sipas Nenit 187, paragrafi 1 i LPK më 10 dhjetor 2010 ankesa iu ishte dërguar Komunës së GJILANIT për përgjigje brenda 7 ditëve. Pasi ajo nuk ishte paraqitur deri në skadim të periudhës së parashkruar më 17 dhjetor 2010, më datën 26 janar 2011 Gjykata Komunale e GJILANIT dërgoi ankesën së bashku me dosjen e lëndës në Gjykatën e Qarkut të GJILANIT sipas Nenit 188, paragrafi 1 i LPK.

II. Kompetenca e Trupit Gjykses të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT

4. Kjo lëndë civile e shkallës së dytë AC.nr.35/11 e GJQ të GJILANIT ishte përzgjedhur bazuar në Nenin 5, paragrafi 1, pika c) e Ligjit Nr.03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen dhe Caktimin e lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë ("Ligji Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat") përmes aktvendimit të lëshuar më datën 18 korrik 2011 nga Gjyqtari i EULEX-it duke vepruar si i deleguar i Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it sipas Vendimit ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2496/ff/11, të datës 5 korrik 2011. Ky i fundit pas kryerjes së marrjes së procedurës sipas Nenit 5, paragrafi 7, fjalia e parë e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat në lidhje me Nenin 3, paragrafi 7 të Udhëzimeve për Përzgjedhje dhe Caktim të Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në lëndët civile, të aprovuar nga Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it më datën 27 janar 2011, të lëshuar më 3 gusht 2011 aktvendimin sipas Nenit 5, paragrafi 7, fjalia e dytë e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat për caktimin e lëndës Trupit gjykses të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT sipas Nenit 5, paragrafët 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat me Kryetarin e Trupit Gjykses të EULEX-it dhe dy anëtarëve – gjyqtarë kosovarë, të emëruar pas heqjes së Vendimit ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2496/ff/11 të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 5 korrik 2011 sipas Nenit 5, paragrafi 5 i Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat me Vendim Agj.nr.161/11 të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 4 gusht 2011.

5. Duke qenë ligjërisht i përbërë në pajtim me kriteret e specifikuar të Nenit 5, paragrafët 1, 2, 4, 5 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, ky trup gjykses i Gjykatës së Qarkut të GJILANIT është i autorizuar të vendos AC.nr.35/11 bazuar në kompetencat funksionale të gjykatës së shkallës së dytë, të paraparë me dispozita të përgjithshme të Nenit 15, paragrafi 2 dhe Neni 176, paragrafi 3 i LPK.

III. Lejimi i ankesës dhe procedura e shkallës së dytë

6. Nuk ekzistojnë pengesa procedurale për të vendosur në ankesë. Në vend të parë, parashtrimi i saj nuk është i ndaluar por qartazi i paraparë me Nenin 176,

paragrafi 1, fjalia e parë e LPK si vendim i kundërshtuar është aktgjykimi i shkallës së parë në bazë të cilësisë së padisë. *Në vend të dytë*, ankesa nuk është e vonuar sipas kriterëve të nenit 186, paragrafi 2 i LPK. Aktgjykimi C.nr.559/2002 i Gjykatës Komunale të GJILANIT, i datës 6 tetor 2010 iu ishte dorëzuar ILMI BRAHIMIT më datën 19 nëntor 2010. Ankesa e tij ishte dorëzuar në Gjykatën e Qarkut të GJILANIT përmes Gjykatës Komunale të GJILANIT më datën 30 nëntor 2010 brenda 15 ditëve të periudhës së parashkruar me Nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK. *Në vend të tretë*, ankesa nuk është e palejueshme sipas Nenit 186, paragrafi 3 i LPK. Është paraqitur nga paditësi në procedurë të shkallës së parë i cili ka të drejtën dhe interesin ligjor të paraqes atë dhe nuk e ka tërhequr atë. *Në vend të katërt*, ankesa ka përmbajtjen mandatore sipas Nenit 178, pika a) – d) të LPK dhe nuk është jo e plotë sipas nenit 179, paragrafi 1 i LPK. Si rezultat, nuk ka bazë ligjore për të përjashtuar lejimin e ankesës dhe/apo procedurën e shkallës së dytë sipas Nenit 176 – 205 të iniciuar nga ajo.

IV. Përmbledhje e procedurës së shkallës së parë.

7. Më datën 25 tetor 2002, ILMI (RAIF) BRAHIMI si paditës paraqiti padi kundër Komunes së GJILANIT si e paditur për vërtetimin e së drejtës së pronësisë me vlerë të kontestit 200 Euro. Gjoja se në vitin 1981 me një kontratë gojore me pronarin e mëhershëm SHEFQET SOPI, paditësi bleu ngastrën katastrale nr.918 në vendin e quajtur “POPOVICA”, me kulturë – arë, e klasit të 4, me sipërfaqe prej 00.32.20 ha, e regjistruar në Listën Poseduese Nr.1750, që është në kufi me ngastrën katastrale te tij nr.920/2, e regjistruar në Listën Poseduese nr.4165. Pas pagesës së çmimit, paditësi hyri në posedim të ngastrës katastrale nr. 918 dhe e kishte përdorur atë më tutje duke mos qenë të penguar nga ndokush. Derisa ai aplikonte për bartje të saj në katastër, ai gjeti regjistrimin ekzistues të kësaj prone të paluajtshme në emër të Komunes së GJILANIT. Kjo ishte e pamundshme pasi që ngastra katastrale nr. 918 ishte e rrethuar nga pronat private dhe në vazhdimësi ishte përdorur nga pronarët e mëhershëm. Kërkesë padia ishte të vërtetoj pronën e paditësit në ngastrën e kontestuar katastrale, të obligoj të paditurin të njeh të drejtën e tij dhe të lejoj regjistrimin e saj nga Drejtoria për Gjeodezi, Katastër dhe Pronë (DGJKP) – GJILAN në emër të paditësit, si dhe të kompensoj shpenzimet e tija për procedurë brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të aktgjykimit.

8. Padia ishte regjistruar për vendosje në C.nr.559/2002 të Gjykatës Komunale të GJILANIT. Nuk ishte caktuar ndonjë seancë paraprake në lëndën bazuar në përjashtimin për kryerjen e saj të paraparë në Nenin 284, paragrafi 4 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 4/1977, 36/1980, 69/1982, 58/1984, 74/1987, 57/1989, 20/1990, 27/1990, 35/1991 dhe Gazeta Zyrtare e RSS Nr. 27/1992, 31/1993, 24/1994, dhe 12/1998).

9. Procedura e shkallës së parë e filluar drejtëpërdrejt me seancën kryesore të mbajtur me datën 4 shkurt 2003, se fundi e shtyer për datën 17 shkurt 2003, 17 mars 2003, 1 prill 2003 dhe 15 dhjetor 2008.

10. Me aktvendimin C.nr.559/02 te Gjykates Komunale të GJILANIT, të datës 26 dhjetor 2008, kjo procedurë kontestimore është pezulluar për 180 ditë të periudhës kohore sikurse të jet inicuar kundër autoritetit publik bazuar në Nenin 277, pika f) e LPK, Nenet 67 dhe 68 te Ligjit Nr. 03/L-048 në Menagjimin Financiar Publik dhe Pergjegjësinë me njoftimet në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

11. Pas skadimit të periudhes së pezullimit, procedura kontestimore ishte përfunduar dhe vazhduar me takimet e seancës kryesore me datën 25 nentor 2009, 28 janar 2010, 16 mars 2010, 21 prill 2010, 26 maj 2010, 9 gusht 2010, 15 shtator 2010 dhe 6 tetor 2010. Pas perfundimit të gjitha ketyre fazave, seanca e shkallës së parë ishte përfunduar sipas Nenit 436, paragrafi 1 i LPK.

12. Me aktgjykimin C.nr.559/2002 te Gjykates Komunale të GJILANIT, të datës 6 tetor 2010 kerkesë padia ishte refuzuar si e pabazuar. Në arsyetim ishte cekur se kontrata mbi shitblerjen për ngastren katastrale nr.918 ishte lidhur nga paditësi me të ndjerin SHABAN SHURDHANI i cili nuk ishte pronari i saj, pasi që ajo ishte e regjistruar në emër të RAHIM MUHARREM NAMANI dhe ISLAM DAUT ISLAMIT si bashkë-pronarë me pjese ideore $\frac{1}{2}$, secila nga ato deri ne vitin 1962 – 1963 kur regjistrimi i saj ishte ndryshuar si pronësi shoqërore e Kuvendit Komunal te GJILANIT. Gjykata e shkallës së parë arriti në përfundim që i ndjeri SHABAN SHURDHANI nuk mund ti transferonte paditësit këtë pronë të paluajtshme pasi që ai nuk ishte vet bartës i të drejtës pronësore. Bazuar në Nenin 452, paragrafi 2 i LPK, ishte vendosur qe palët të bartin shpenzimet e procedures vet pa kompensim.

V. Shqyrtimi i padisë të paditurit te gjykates se shkalles se dyte sipas Nenit 194 te LPK

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedures kontestimore – Neni 182 i LPK

13. Arsyeja e parë për refuzim të aktgjykimit C.nr. 552/02 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 6 tetor 2010 është sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) e LPK per *shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) e LPK*. Megjithatë, formulimi i saj është vetëm pjesërisht i cituar pa ndonjë konkretizim bazuar në përmbajtjen e aktgjykimit të ankimuar. Asnjë gabim duke përjashtuar shqyrtimin e saj janë të specifikuar nga paditësi qe mund te shqyrtohet nga ky trup gjykues. Dispozitivi eshte i kuptueshem dhe jo ne kundershtrim me veteveten apo me arsyetimin. Ne pajtueshmeri me Nenin 160, paragrafi 4 i LPK deklaratat e arsyeve perfshijne, *inter alia*, konstatimet per faktet e kontestueshme relevante, te vertetuara ne procedure me deshmine e perdorur per percaktimin e tyre, si dhe vleresimin e tyre ligjor. Aktgjykimi permban arsye te qarta dhe objektive ne lidhje me faktet materiale, vendimtare ne kete kontest, te cilat nuk jane te dykuptimshme apo kontradiktore. Perkundrazi, arsyet jane bindese, te kuptueshme dhe teresisht arsyetojne aktgjykimin e marre. Nuk ekziston ndonje mosperputhje ndermjet atyre sipas dokumenteve dhe shenimeve te deklaratave te dhena ne kete

lende dhe permbajtjen e tyre aktuale. Prandaj, trupi gjykues konsideron qe arsyeya procedurale sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) e LPK ne ankese eshte e pabazuar dhe nuk perjashton qendrushmerine e aktgjykimit.

14. Asnje shkelje e procedures kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) te LPK qe gjykata e shkalles se dyte eshte e obliguar te shqyrtoj *ex officio* jane percaktuar ne kete shqyrtim te padise sipas nenit 194 te LPK. Aktgjykimi ishte marre ne padine qe bie brenda kompetencave ekskluzivisht territoriale te Gjykates Komunale te GJILANIT sipas Nenit 41 te LPK ne kontestet e prones se paluajtshme (*Neni 182, paragrafi 2, pika b) i LPK*). Ai nuk ishte i bazuar ne vendosje te paleve sipas Nenit 3, paragrafi 3 i LPK (*Neni 182, paragrafi 2, pika g) e LPK*). Asnjeres prej paleve ndergjyqese nuk iu eshte mohuar e drejta e perkthimit ne gjuhen e tij/saj ametare ne seancen kryesore siq eshte parapare nga Neni 96 i LPK (*Neni 182, paragrafi 2, pika j) e LPK*). Personat te cilet kane marr pjese ne lende kane pasur te drejte te veprojne si pale ne procedure me kapacitetin e nevojshme procedural dhe perfaqesim te duhur (*Neni 182, paragrafi 2, pika k) e LPK*). Publiku i seances kryesore i garantuar me Nenin 444, paragrafi 1 i LPK nuk ishte perjashtuar ne ndonjeren nga seancat e mbajtura (*Neni 182, paragrafi 2, pika m) i LPK*).

15. Brenda kufizimeve te shqyrtimit te padise ne menyre thelbesore e parapare me Nenin 194 te LPK, gjykata e shkalles se dyte konkludon qe shkelja e dispozitave te procedures kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) e LPK e treguar ne ankese dhe ato sipas Nenit 182, paragrafi 2, pikat b), g), j), k) dhe m) te LPK, kontrolluan *ex officio*, nuk ekzistojne. Asnje shkelje tjeter procedurale, pa marre parasysh realitetin e tyre, mund te shqyrtohej pasi qe ato nuk jane te perfshira ne fushen e lejueshme te shqyrtimit te padise, i kufizuar me Nenin 194 te LPK. Prandaj, aktgjykimi i kundërshtuar nuk mund te anulohet per arsye procedurale sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) e LPK.

Vertetim i gabuar dhe jo i plote i gjendjes faktike – Neni 183 i LPK

16. Arsyeya e dyte ne ankese eshte sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika b) e LPK per *vertetim te gabuar dhe jo i plote i gjendjes faktike*. Megjithate, gjithashtu ai eshte i pabazuar sipas kriterëve te nenit 183, paragrafi 1 i LPK – gjykata e shkalles se pare nuk ka vertetuar ndonje fakt material relevant ne menyre te pasakte dhe nuk ka deshtuar te percaktoj ate.

17. Eshte ne menyre te pakontestueshme e percaktuar nga aktgjykimi i ankimuar qe prona e kontestueshme e paluajtshme eshte **ngastra katastrale nr. 918**, e cila ndodhet ne vendin e quajtur “POPOVICA”, me kulture – are, klasi i 4, me siperfaqe prej 00.32.20 ha (3 220 m²), fillimisht e regjistruar ne **Fleten Poseduese nr. 1755**, ZK GJILAN ne emer te **ISLAM DAUT ISLAMI dhe RAHIM MUHARREM NIMANI**, te dy nga GJILANI, me pjese ideore ½ per secilin nga ata. Ne vitin 1962 – 1963 pas ndrrimit ne pronen e vet me numer rendor nr. 218/62, ngastra e njejte katastrale nr.918 ishte regjistruar ne **Fleten Poseduese te re Nr. 1750**, ZK GJILAN si *pronesi*

shoqerore e Kuvendit Komunal te GJILANIT pa ndonje ndryshim pasues sa i perket vendndodhjes, siperfaqes, kultures, kategorise dhe statusit. Eshte e rrethuar nga ngastra katasatrale nr. 920/1 te RIDVAN HAMITIT, ngastres katastrale nr. 916 te HALIL RAFUNA, ngastres katastrale nr. 913 te BLAGIČA VUCKOVIČ, ngastres katastrale nr. 935 te NIKOLA DIMITRJEVIČ, ngastres katastrale nr.917 – prones shoqerore dhe ngastren katastrale nr. 907 te ILIJA ČVETKOVIČ. Keto fakte lidhur me karakteristikat dhe regjistrimin e prones se kontestueshme te paluajtshme jane vertetuar me deshmite ne vijim te administruara ne procedure te shkalles se pare: konstatimet me shkrim dhe mendimi i eksperteve te gjeodezise MUSA RAMA dhe XHELAL HAZIRI, te dates 18 shkurt 2003, ato te atyre shtese, te dates 19 prill 2010 dhe 19 maj 2010, kopjen perkatese te planit nr. 5, skicen nr. 16, Shenimet e Listes Poseduese -1962, inspektimi ne vend te ngjarjes me 17 shkurt 2002, Lista Poseduese e Pjesshme nr. 1750 te leshuar nga Departmenti per Kataster, Gjeodezi dhe Prone – GJILAN me daten 2 tetor 2002 dhe 17 shkurt 2003, si dhe Certifikaten per te Drejtat e Prones se Paluajtshme nr. P-70403013-00918-0, te leshuar nga Zyra Komunale Katastrale – GJILAN me 20 prill 2010.

18. Me kontraten mbi shitblerjen per pronen e paluajtshme Vr.nr.143/1981, te vertetuar nga Gjykata Komunale e GJILANIT me 4 shkurt 1981 GAGICA RAZA si pronare e **ngastres katastrale nr. 920**, qe gjindet ne vendin e quajtur “POPOVICA”, me kulture – are, klasi i 4, me siperfaqe prej 1.16.85 ha ne pajtim me Listen Poseduese nr. 2406, ZK GJILAN, i ka shitur nje pjese te saj me siperfaqe prej 0.38.95 ha (3 895 m²), IBRAHIM RAIF BRAHIMI nga GJILANI me cmimin prej 20 000 dinar. Pas formimit katastral te pjeses se paluajtshme te blere, ishte regjistruar ne emer te blesesit si **ngaster katastrale nr. 920/02**, ngastra katastrale fqinje nr. 918 me kufijte e saj jugor-perendimor, e deshmuar me kopje te planit nr. 5, skica nr. 16. *Asnje lidhje tjeter faktike apo ligjore nuk eshte pretenduar apo deshmuar ndermjet ketyre dy pronave.*

19. Ne baze te deshmive te deshmitareve ENVER SHABANI, RIDVAN HAMITI dhe SHEFQET SOPI te shqyrtuar ne seance me 1 prill 2003 dhe seanca e ILMI IBRAHIMIT ne seance me 21 prill 2010, ne pjeset e atributuara nga gjykata e shkalles se pare, ne vitin 1981 ishte lidhur kontrata mbi shitblerjen ndermjet tani te ndjerit SHABAN SHURDHANI si shites dhe ILMI BRAHIMIT si bleses per ngastren katastrale nr. 918 ne cmimn ne dinare, ne barazvlere prej 6 000 DM. Kontrata ishte lidhur ne menyre gojore, pa qene e nenshkruar me shkrim dhe pa qene e vertetuar nga gjykata. SHABAN SHURDHANI nuk ka prezantuar ndonje dokument – prone titull per ngastren katastrale nr. 918. Pasi qe cmimi ishte paguar, posedimi i prones se paluajtshme iu ishte dorezuar ILMI BRAHIMIT i cili akoma ne menyre te panderprere kishte punuar pjesen pjellore te kesaj are, pa qene te penguar apo ndryshe ndaluar nga ndokush.

20. Ne seancen anikimore sipas Nenit 190, paragrafet 2 dhe 4 te LPK deshmia e re iu eshte sjellur per *shnderrimin e bashke pronesise private* ne ngastren katastrale nr.

918 në *pronë shoqërore*. Në Arkivin Regjional të GJILANIT është gjetur në mënyrë të rregullt - është mbajtur në origjinal dhe është prezantuar në dosje të plotë të lëndës të vërtetuar në mënyrë zyrtare nr. 166/63 të Komunës së GJILANIT për regjistrim të ndryshimeve katastrale nr. 04-2276/63 bazuar në Vendimin nr.01-2276/2-63. Ai përmban procesverbalin nr.03-2776/1, të hartuar më datën 1 mars 1963 në zyrën e Sektorit për Marrdhënie me Pronë të Paluajtshme të Këshillit Popullor të Komunës së GJILANIT, të regjistroj deklaratën nga ISLAM ISLAMI para atij organi si pronar i ngastres katastrale nr. 918, me të cilën ai vullnetarisht dhe pa qene i detyruar nga ndokush ka hequr dorë nga të gjitha të drejtat mbi të, që do të thotë në shfrytëzim dhe disponim të përhershëm, në dobi të shtetit – Komunes se GJILANIT. Ai e arsyetoi vetën me pamundësinë për të kultivuar tokën për shkak të punësimit të tij nga një ndërmarrje komunale, pagesën e taksave hyrëse për të, përjashtimin nga mbështetja e shtesave fëmijërore, dhe nevojën për shfrytëzimin e ardhshëm të saj në interes publik. ISLAM ISLAMI nënshkroi procesverbalin për deklaratën e tij me 1 mars 1963 pa ndonjë vërejtje në përmbajtjen e saj. Sipas letres nr. 03-45, të datës 6 mars 1963 të Sektorit të Financave të Këshillit Popullor të Komunës së GJILANIT, Zyra e saj katastrale lëshoi një kopje të Fletës Poseduese nr. 1755, të datës 8 mars 1963 duke verifikuar që në atë datë ngastra katastrale nr. 917 në vendin e quajtur “POPOVICA”, me kulturë – arë, e klasit të 4, me sipërfaqe prej 00.07.04 ha (704 m²), dhe ngastra katastrale nr. 918 në vendin e quajtur “POPOVICA”, me kulturë – arë, e klasit të 4, me sipërfaqe prej 00.32.20 ha (3 220 m²), me sipërfaqe të përgjithshme prej 00.39.24 ha (3 924 m²), ishin regjistruar si bashkë-pronësi në emër të ISLAM DAUT ISLAMIT me ½ të Këshillit Popullor të Komunës së GJILANIT me ½ . Me vendimin Nr.01-2776/2 të Këshillit Popullor të Komunes së GJILANIT, të datës 10 maj 1963 në bazë të Nenit 46 të Ligjit mbi Këshillin Popullor Komunal, Neni 66b të Ligjit mbi Bartjen e Tokës dhe Objekteve, Nenet 205 dhe 210 të Ligjit mbi Procedurën Administrative dhe Nenin 28 të Statutit të Komunes se GJILANIT, toka e dorezuar nga ISLAM ISLAMI, e regjistruar në Fletën Poseduese nr. 1755 si ngastër katastrale nr. 917 dhe nr. 918 me sipërfaqe prej 00.19.50 ha (1 950 m²), me kulturë – fushë, në vendin e quajtur “POPOVICA”, ishte pranuar. Nje herë ishte urdheruar vendimi të behet i plotefuqishem dhe të dergohet ne Zyren Katastrale te GJILANIT per regjistrim te kesaj prone te paluajtshme ne fleten poseduese si prone shoqerore te Keshillit Popullor te Komunes se Komunes se GJILANIT. Regjistrimi i ngastrës katastrale nr. 918 ishte ndryshuar në mënyrë të duhur, e dëshmuar nga Certifikata për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. P-70403013-00918-0 të Zyrës Katastrale Komunale – GJILAN më 25 gusht 2011.

21. Gjendja faktike e vërtetuar pas shqyrtimit direkt të lëndës nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë mbetet pa ndryshime thelbësore në krahasim me atë që përmbante Aktgjykimi C.nr.559/02 i Gjykatës Komunale të GJILANIT, i datës 6 tetor 2010 për sa i përket fakteve kryesore ligjore e që janë relevante, që do të thotë, se ngastra kadastrale nr.918 pasi që ishte në bashkëpronësi private në pjesë ideale prej 1/2 i dy personave fizik, në 1962-1963 shndërrohet në pronësi shoqërore pa ndryshime

pasuese të pronës dhe/ose të regjistrimit kadastral. Me që pas grumbullimit të provave të reja në procedurë të shkallës së dytë është vërtetuar gjendja faktike, e cila, edhe pse me më shumë detaje, nuk dallohej në esencë nga gjendja faktike e vërtetuar në Aktgjykimin e shkallës së parë, kjo e fundit nuk mund të kualifikohet as e gabuar e as jo e plotë. Me që Neni 319, paragrafi 2 LPK kërkon vetëm *fakte lidhëse* për ta provuar vendimin në procedurë, mos-vërtetimi i statusit të pronës së ngastrave fqinje, dhe pronësia mbi ngastrën nr.918 pas vitit 1981 nuk do të thotë se Aktgjykimi i atakuar ka qenë jo i plotë meqenëse këto fakte janë jo-relevante për blerjen e patundshmërisë kontestuese. Argumentet e ankuesit lidhur me arsyen e dytë në ankesë sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK, janë të pabaza – gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata e shkallës së dytë nuk është as e gabuara e as jo e plotë sipas Nenit 183 LPK.

Zbatimi i gabueshëm i drejtës materiale - Neni 184 LPK

22. Sipas Nenit 194 LPK kjo Gjykatë e shkallës së dytë do ta shqyrtoj Aktgjykimin e atakuar brenda kufijve të arsyeve të treguara në ankesë, sikurse edhe *sipas detyrës zyrtare për zbatimin e gabuar të drejtës materiale* sipas Nenit 184 LPK.

23. Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësoro Juridike (LMThPJ) (Gazeta Zyrtare RSFJ, Nr. 6/1980), në fuqi prej 1 shtator 1980 (Neni 90) deri me 20 gusht 2009 (Nenet 296 – 297 të Ligjit Nr.03/L-054 mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, No.57/2009), në Kosovë në fuqi nga 22 mars 1989 është ligji i aplikueshëm bazuar në Nenin 1.1 (b) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24, si të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/59 në qershor 1981, momenti i pretenduar për blerjen e ngastrës kadastrale nr.918 nga ana e ILMI BRAHIMI. Sistemi ligjor mbi të drejtat pronësore i themeluar nga LMThPJ është i definuar sipas ligjit në të gjitha elementet e saja. Neni 1 i LMThPJ përcakton se qytetarët mund janë mbajtës të të drejtave pronësore *vetëm brenda kufijve dhe sipas kushteve të caktuara me ligj*, Neni 2, paragrafi 2 LMThPJ *ndalon ekzistencën e tij mbi objektet në pronësi shoqërore*, kështu që Neni 20 LMThPJ *saktësisht rendit arsyet ligjore për fitimin e tyre duke qenë, një veprim juridik, trashëgimi ose një vendim i organit kompetent shtetëror*. Pajtueshmëria me të gjitha këtë kërkesa ligjore të LMThPJ nuk është dëshmuar në këtë rast për sa i përket fitimit të ngastrës kadastrale nr.918 nga ana e ILMI BRAHIMI, edhe pse sipas Nenit 319, paragrafi 1 dhe Nenit 322, paragrafi 1 LPK, si paditës në procedurë ai ka për detyrë të dëshmoj për të gjitha faktet mbi të cilat bazohet padia e tij, domethënë *se e drejta pronësore mbi patundshmërinë e kontestuar është bërë ekzistuese për te*.

24. Pronësia mbi ngastrën kadastrale nr.918 nuk është dëshmuar se është blerë nga ana e ILMI BRAHIMI mbi bazat e një *shitblerjeje ligjore* sipas Nenit 20, paragrafi 1, fjalia e dytë lidhur me Nenin 33 LMThPJ. *Së pari*, sipas Nenit 3, paragrafi 1 LMThPJ *vetëm titullari i të drejtës pronësore ka të drejtë të disponoj me te brenda kufijve të caktuara me ligj*. Në mënyrë të ngjashme, sipas Nenit 4, paragrafi 1 të Ligjit mbi Shitblerjen e Patundshmërive (Gazeta Zyrtare e RSS, Nr. 15/1974 dhe 14/1977)

(“LShPP 1974”), në fuqi për tërë territorin e Republikës së Serbisë (Neni 64) nga 22 prill 1974 (Neni 65, paragrafi 2) deri në shfuqizimin e tij me 10 gusht 1981 sipas Nenit 34, paragrafi 1 i Ligjit mbi Shitblerjen e Patundshmërive (Gazeta Zyrtare e RSS Nr. 43/1981, 24/1985, 28/1987, 6/1989 dhe 40/1989) (“LShPP 1981”) *qytetarët mund të transferojnë vetëm patundshmërinë mbi të cilën ata kanë të drejtën e pronësisë*. E njëjta kërkesë e rivendosur në Nenin 4, paragrafi 2 të LShPP 1981 për tërë territorin e Republikës së Serbisë (Neni 33) nga 10 gushti 1981 (Neni 35) konstaton se *kontratat mbi bartjen të patundshmërive mund të lidhen vetëm me titullarët e të drejtës së pronësisë*. Ligji mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 45/1981 dhe 29/1986) sipas Nenit 1, paragrafi 1 nuk ishte i aplikueshëm në këtë çështje të rregulluar sipas ligjeve republikane të sipërpërmendura në mënyrë të barabartë për tërë territorin e Republikës së Serbisë në atë kohë, dhe për më tepër, asnjëra nga dispozita e saja nuk e hiqte këtë kërkesë themelore *pronësia mbi pronën e paluajtshme të bartet nga ana e titullarit të së drejtës pronësore mbi atë*. Megjithatë, kjo cilësi nuk është dëshmuar në këtë rast as për SHEFQET SOPI fillimisht i specifikuar në padi si shitës prej kujt ILMI BRAHIMI bleu ngastrën kadastrale nr.918, e as për SHABAN SHURDHANI i specifikuar si shitës i tij gjatë rrjedhjes së procedurës. Nuk ka çfarë do çoftë prova në formë dokumenti lidhur me këtë. Mos-ekzistenca e tyre është pranuar nga ILMI BRAHIMI sipas Nenit 321, paragrafi 2 LPK në seancën e shqyrtimit kryesor në procedurë të shkallës së parë me 21 prill 2010, sikurse edhe në seancën dëgjimore lidhur me ankesë në procedurë të shkallës së dytë me 30 shtator 2011 *me pohimin se atij kurrë nuk iu është prezantuar nga shitësi i ngastrës kadastrale nr.918 një dokument- si titullar i pronësisë* bazuar në të cilën ai mund ta tregoj të drejtën e pronësisë sipas nenit 34, paragrafi 2 LMThPJ. Ekspertët e gjeodezisë të caktuar nga Gjykata e shkallës së parë në seancën kryesore me 6 tetor 2010 sipas nenit 366, paragrafi 1 LPK vërtetoj *se as SHEFQET SOPI, e as SHABAN SHURDHANI kurrë nuk kanë qenë të regjistruar si pronar/pronarë të ngastrës kadastrale nr.918*. Më në fund, kjo pronë nuk mund të konsiderohet si e fituar nga i dyti bazuar në parashkrimin pozitiv – *së pari*, kjo bazë për fitim është paraqitur me Nenin 21 lidhur me Nenin 90 LMThPJ nga 1 shtator 1980 pa retroaktivitet për periudhën 1967 – 1980 kur sipas dëshmitarit ENVER SHABANI, të dëgjuar me 1 prill 2003, familja e SHABAN SHURDHANI e shfrytëzonte patundshmërinë e kontestuar; *së dyti*, dëshmitë e njëjta nuk vërtetuan posedimin pa pengim për minimum prej 20 vitesh, por vetëm për 13 vite nga 1967 e deri 1980; *së treti*, pas transformimit në vitin 1963 në pronë shoqërore, kjo pronë e paluajtshme nuk ka mundur të posedohet ose të fitohet nga një qytetar për shkak të ndalesës për ndryshime të tilla që e ndikojnë në statusin e pronës sipas Nenit 3 LShPP 1974 dhe ligjeve të mëparshme republikane të cilat kufizojnë qarkullimin e pronës shoqërore. Duke përmbledhur, ILMI BRAHIMI nuk e fitoj ngastrën kadastrale nr.918 bazuar në kontratën e lidhur me 1981 me SHEFQET SOPI sipas pretendimeve të tij në padi, ose SHABAN SHURDHANI sipas pretendimeve të tij në procedurë *me që asnjëri nga ata nuk ishte titullar i pronës dhe nuk mundej ta bëjë ligjërish bartjen e saj*. Meqenëse

kontrata e shitblerjes i tejkalonte kufijtë e themeluara sipas Nenit 3, paragrafi 1 *in fine* LMThPJ, sipas Nenit, paragrafi 1 LSHPP 1981 ILMI BRAHIMI nuk e fitoj pronësinë mbi bazat e pronës së kontestuar të paluajtshme. *Së dyti*, shitblerja e njëjtë nuk ishte në pajtueshmëri me kërkesat e detyrueshme për sa i përket bazueshmërisë së saj. Siç është pranuar në mënyrë eksplicite nga ILMI BRAHIMI në seancën për shqyrtim të ankesës, ai e bleu ngastrën kadastrale nr.918 nga SHABAN SHURDHANI në qershor 1981 *përmes një kontrate gojore* e cila nuk ishte me shkrim dhe e nënshkruar dhe nuk ishte vërtetuar nga Gjykata siç kërkohet me Nenin 10, paragrafi 1 LShPP 1974 deri 10 gusht 1981. E lidhur në kundërshtim me këtë dispozitë, sipas Nenit 10, paragrafi 2 LShPP 1974 shitblerja ndërmjet SHABAN SHURDHANI dhe ILMI BRAHIMI nuk prodhohet efekt ligjor. Për atë, mungesa e kësaj forme të paraparë me Nenin 10, paragrafi 1 LShPP 1974, për ligjshmërinë e të gjitha kontratave mbi bartjen e pronës së paluajtshme rezultojnë në – *pavlefshmëri* në çështjen e lartcekur sepse në momentin e lidhjes së saj – qershor 1981 – LShPP 1974 nuk ka paraparë diç tjetër sipas Nenit 10 të saj, paragrafi 2 *in fine*. Domethënë, LShPP 1974 as nuk e përjashtoj *pavlefshmërinë* e kësaj kontrate që nuk është lidhur në formë siç është paraparë me Nenin 10, paragrafi 1, e as nuk lejoj *legalizimin e saj përmes përmbushjes*. LShPP 1981 i cili shfuqizoj LShPP 1974 me 10 gusht 1981, sipas Nenit të saj 4, paragrafi 2 në mënyrë identike kërkoj që të gjitha kontratat mbi bartjen e pronës së paluajtshme duhet të lidhen *me shkrim me vërtetimin e nënshkrimeve të palëve kontraktuese nga ana e Gjykatës*. Ato të cilat nuk i përmbaheshin kërkesave të Nenit 4, paragrafi 2 LShPP 1981 ishin nulë dhe të pavlefshme - Neni 4, paragrafi 3 LShPP 1981. Asnjë përjashtim nuk është paraparë deri me 1 gusht 1987, kur është shtuar paragrafi i ri - 4 Nenit 4 LShPP 1981 (Gazeta Zyrtare e SRS No.28/1987), ku thuhet se kontratat mbi bartjen e të drejtës së pronës së paluajtshme të lidhura me shkrim pa nënshkrimet e palëve e të vërtetuara nga ana e Gjykatës mund megjithatë të konsiderohen valide, nëse janë përmbushur, nëse kufijtë e ligjit nuk janë tejkaluar, taksat që duhet paguhen janë caktuar, dhe e drejtat e përparësisë dhe të interesat tjera shoqërore janë respektuar. Ky legalizim nuk është i aplikueshëm, megjithatë, për shitblerjen e 1981 ndërmjet SHABAN SHURDHANI dhe ILMI BRAHIMI *meqenëse nuk është lidhur me shkrim* siç kërkohet nga Neni 4, paragrafi 4 LShPP 1981. Nuk mund të konsiderohet valide gjithashtu sipas Nenit 73 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr.29/1978, 39/1985, 45/1989, 57/1989 dhe 31/1993). *Së pari, si lex generalis* për të gjitha kontratat është deroguar sipas Nenit 4, paragrafi 4 LShPP 1981 si *lex specialis* për ato kontrata mbi bartjen e pronës së paluajtshme. *Së dyti*, vetëm kontratat lidhja e të cilave është bërë e varur nga një formë *e thjeshtë e shkruar* mund të legalizohet përmes përmbushjes bazuar në Nenin 73 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore dhe anasjelltas por jo të atyre mbi bartjen e të drejtave në pronën e paluajtshme me që forma e paraparë për vlefshmërinë e tyre sipas Nenit 10, paragrafi 1 LShPP 1974 deri me 10 gusht 1981 dhe Neni 4, paragrafi 2 LShPP 1981 pas asaj date është *kualifikuar forma me shkrim me nënshkrimet e palëve, të vërtetuar nga ana e Gjykatës*. “Përmbushja themelore” përjashtimi sipas Nenit 73 të Ligjit mbi

Marrëdhënie Detyrimore nuk mund të aplikohet te kontratat mbi bartjen e pronës së paluajtshme sepse ajo mund ta zëvendësoj vetëm *mosnënshkrimin e saj në formë të shkruar kur ajo është e vetmja kërkesë zyrtare për efektin detyrues ligjor* dhe jo të tria elemente që kërkojnë për ta kompletuar bartjen e të drejtave pronësore mbi pronën e paluajtshme (kontratë me shkrim, vërtetimi i tij nga ana e Gjykatës dhe regjistrimi kadastral). *Së treti*, si një formë e paraparë sipas Nenit 10, paragrafi 1 LShPP 1974 deri me 10 gusht 1981 dhe Neni 4, paragrafi 2 LShPP 1981 në *qëllimin e saj të qartë* shkon përtej përmbushjes së obligimeve të palëve në kontratën individuale siç është përcaktuar për të garantuar stabilitet në dokumente dhe në qarkullim të pronës me interes shoqëror, mungesa e tij është që të sanksionohet me *pavlefshmëri* sipas nenit 70, paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhënie Detyrimore, kështu që legalizimi përmes përmbushjes duhet të jetë e paaplikueshme sipas Nenit 73 *in fine*. Kështu që, kontrata e shitblerjes e arritur gojarisht në qershor 1981 në mes të SHABAN SHURDHANIT dhe ILMI BRAHIMIT pa e nënshkruar atë dhe pa e vërtetuar në gjykatë, për shkak të mungesës së formës së vlefshmërisë sipas Nenit 10, paragrafit 1 LShPP 1974 (Neni 4, paragrafi 2 LSHPP 1981) është *nule dhe i pavlefshëm pa efekt juridik* – Neni 10, paragrafi 2 LSHPP 1974 (Neni 4, paragrafi 3 LSHPP 1981). Ai nuk mundet të konsiderohet i vlefshëm as bazuar në Nenin 10, paragrafin 2 *in fine* LSHPP 1974 pasi që ligji nuk e ka paraparë vlefshmërinë, e as bazuar në nenin 4, paragrafi 4 LSHPP 1981 pasi që e njëjta kontratë përpos që nuk ka qenë e vërtetuar nga gjykata ajo nuk ka qenë as e nënshkruar në formë të shkruar nga shitësi dhe blerësi. Jorelevante për vlefshmërinë e saj është çmimi i paguar nga ILMI BRAHIMI dhe posedimi në ngastrën kadastrale nr.918 i dorëzuar nga SHABAN SHURDHANI pasi që në pajtim me Nenin 73 *in fine* të Ligjit mbi Detyrimet qëllimi i mungesës së formës me shkrim me nënshkrimet e palëve, të vërtetuar nga gjykata, tejkalon përmbushjen e obligimeve të tyre kontraktuale, duke garantuar në përgjithësi stabilitetin e bartjeve të pronës së paluajtshme. *Së katërti*, siç pranohet nga ankuesi në séancën dëgjimore me 30 shtator 2011, nuk ka pasur asnjë pengesë administrative, tatimore dhe/apo ligjore për të nënshkruar kontratën me SHABAN SHURDHANIN për ngastrën kadastrale nr.918 me shkrim dhe vërtetimin e saj në gjykatë dhe ajo është arritur vetëm gojarisht për shkak të neglizhencës së tyre subjektive. Në lidhje me këtë argumenti i paraqitur në séancën dëgjimore me 1 prill 2003 nga avokati MUSTAFË MUSA, përfaqësues i autorizuar i ILMI BRAHIMI në procedurat e shkallës së parë, është i pabazuar, duke arsyetuar përfundimin joformal të kontratës me nevojën për të ofruar pëlqimin e Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë sipas Nenit 3 të Ligjit mbi Kufizimet e Bartjes të Pronës së Paluajtshme. Ajo ishte publikuar në Gazetën Zyrtare të RSS Nr. 30/1989 me 22 korrik 1989 dhe ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë sipas nenit 8 pa retroaktivitet. Një efekt i tillë juridik *ex tunc* nuk ishte nuk ishte paraparë me Ligjin mbi Amandamentet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Kufizimet e Bartjes së Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e RSS, Nr. 42/1989) dhe/ose Ligjin mbi Amandamentet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Kufizimet e Bartjes së Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e RSS, Nr.22/1991), e cila e ri-emëroi atë në *Ligjin mbi Kushtet Specifike për*

Bartjen e Pronës së Paluajtshme . Sidoqoftë , mosnënshkrimi i shitblerjes në mes të ILMI BRAHIMIT dhe SHABAN SHURDHANI në formë të shkruar dhe mos vërtetimi i saj nga Gjykata nuk mundet të arsyetohet me mos-aplikimin e këtij ligji diskriminues sipas Nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-it Nr. 1999/24, pasi që regjimi ndalues hyri në fuqi me 22 korrik 1989, 8 vite pas përfundimit joformal të shitblerjes të përmendur më lart. Sa i përket formës dhe procedurës sipas Nenit 10, paragrafi 1 LSHPP 1974 dhe më vonë me Nenin 4, paragrafi 2 LSHPP 1981, ato ishin themeluar ndarazi, nuk kanë qenë të para kushtëzuara me lejen administrative dhe si jo-diskriminuese janë të obligueshme sipas Nenit 1.1, pika (b) e Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/24. Për këtë arsye mos-përputhshmëria me këto kërkesa formale të obligueshme e ka bërë kontratën e shitblerjes të SHABAN SHURDHANI dhe ILMI BRAHIMI nule dhe të pavlefshme pa efekt juridik për sa i përket bartjes të së drejtës pronësore mbi ngastrën kadastrale nr.918. Së pesti, përvetësimi i pronësisë në këtë pronë të paluajtshme nga ILMI BRAHIMI në bazë të transaksionit ligjor përjashtohet pasi që ai kurrë nuk është regjistruar në librat kadastral në pajtim me Nenin 33 LMThPJ. Siç pranohet nga ai në séancën ankimore me 30 shtator 2011, kjo nuk është për shkak të ndonjë të mete teknike, por për shkak të refuzimit nga DGJKP–GJILAN për të regjistruar ngastrën kadastrale nr.918 ne emër të tij për shkak të mos-përbushjes të kushteve për këtë ndryshim. Prandaj, mos-ekzistimi është gjithashtu parakushti i tretë formal për përvetësimin e pronës së paluajtshme të kontestuar në këtë bazë. Shkurt, ILMI BRAHIMI nuk e ka fituar pronën e ngastrës kadastrale nr.918 në bazë të shitblerjes ligjore sipas Nenit 20, paragrafi 1, hipoteza e dytë në lidhje me Nenin 33–34 LMThPJ pasi që kontrata e shitblerjes me SHABAN SHURDHANIN nuk është lidhur me titullarin e të drejtës së pronësisë me shkrim, vërtetuar nga Gjykata dhe e regjistruar në kadastër.

25. Nuk është pretenduar e as dëshmuar në asnjërën fazë të procedurës se ILMI BRAHIMI ka fituar ngastrën kadastrale nr.918 me trashëgimi në pajtim me nenin 20, paragrafin 1, fjalia e tretë në lidhje me Nenin 36 LMThPJ apo me vendimin e çfarëdo autoriteti qeveritar sipas Nenit 20, paragrafit 2, LMThPJ. Poshtu përjashtohet përvetësimi i kësaj të drejte pronësore me vet ligjin në pajtim me nenin 20 paragrafin 1, fjalia e parë në lidhje me Nenin 21 LMThPJ, respektivisht me parashkrim fitues sipas neneve 28 – 30 LMThPJ. Së pari, është konstatuar me siguri ne procedura se që nga viti 1963 ngastra kadastrale nr.918 është regjistruar si pronë shoqërore në emër të Kuvendit Komunal të GJILANIT. Kjo gjendje është vërtetuar në mënyrë zyrtare nga dokumentet publike të administruara në lëndë me efekt të detyrueshëm dhe të dëshmueshëm sipas Nenit 329, paragrafi 1 LPK. Kështu që në Listën Poseduese nr.1750 të DKGJP- GJILAN, të datës 2 tetor 2002 në shtyllën e saj përkatëse “Lloji i pronës” së ngastrës është e vërtetuar si “Shoqërore”, si dhe në shtyllën me emrin e titullit-mbajtësit me shkurtesën “P.SH.” (pronë shoqërore). Në mënyrë të ngjashme në Certifikatën nr.P-70403013-00918-0 të DKGJP–GJILAN të dates 20 prill 2010 dhe 25 gusht 2011 pronar-posedues i ngastrës kadastrale nr.918 është shënuar si “P.SH.” - “pronës shoqërore” (pronë shoqërore). Duke qenë e përpiluar në formën e duhur nga

trupat kompetent, të gjitha këto dokumente publike dëshmojnë se sipas nenit 329, paragrafi 1 LPK me efekt të detyrueshëm të dëshmueshëm *pronësia shoqërore në ngastrën kadastrale nr.918*, si dhe përputhshmëria me kërkesat për regjistrimin e saj si pronë e paluajtshme shoqërore e vendosur sipas Nenit 1, paragrafët 1 dhe 3, neni 3, pika 3) dhe Neni 4, paragrafi 2 i Ligjit mbi Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Pronësi Shoqërore (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 37/1971). *Së dyti*, deri në vitin 1962 – 1963 ngastra kadastrale nr.918 ishte bashkëpronësi private e ISLAM ISLAMIT dhe RAHIM NIMANIT me ½ pjesë ideale për secilin nga ata. Me shkresën nr.166/63 të Komunës së GJILANIT të gjetur në Arkivin Komunal të GJILANIT, është konstatuar se me 1 mars 1963 në zyrën e Sektorit për Marrëdhënie Pronësore të Paluajtshme të Këshillit Popullor të Komunës së GJILANIT, ISLAM ISLAMI ka dhënë deklaratë duke hequr dorë nga të gjitha drejtat pronësore në ngastrën kadastrale nr.918 në favor të shtetit–Komunës së GJILANIT. Kjo heqje dorë e deklaruar nga *qytetari – mbajtësi i të drejtës së pronësisë në këtë tokë bujqësore të pangarkuar me detyrime në formën e kërkuar ligjore të deklarimit të njëanshëm me shkrim para institucionit kompetent në përfitim të bashkësisë shoqërore-ekonomik* në përputhje me Nenin 66b të Ligjit mbi Transferimin e Tokës dhe Ndërtesave (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 26/1954, 19/1955, 48/1958 dhe 30/1962) është transferuar dhe në këtë mënyrë është transformuar kjo pronë e paluajtshme në pronësi shoqërore. Sipas të njëjtës dispozitë, *motivet për këtë heqje dorë janë ligjërisht jo relevante*. Për këtë arsye edhe nëse ISLAM DAUT ISLAMI ka hequr dorë nga ngastra kadastrale nr.918 në mënyrë që ti shmanget përjashtimit nga shtesat fëmijërore dhe për të fituar të drejtën që në të ardhmen ti marr ato , ky motiv nuk ka përjashtuar apo ndryshe ndikuar vlefshmërinë e veprimit të tij. Kjo është arsyeja pse kualifikimi i saj si *fiktiv* i bërë nga Avokati ISA MUSTAFA në séancën ankimore është i pabazuar. Nuk ka asnjë pretendim të bërë në cilëndo fazë të procedurës dhe asnjë çfarëdo qoftë dëshmi e mbledhur se heqja dorë e ISLAM ISLAMIT është bërë në mënyrë të pavullnetshme, nën kërcënim, mashtrim apo me mungesa tjera të vullnetit. Për këtë arsye, nuk ka asnjë bazë faktike dhe dëshmuese për të konsideruar heqjen dorë të *pavlefshme* apo të *anulueshme*. Duke mos qenë e pavlefshme apo e shfuqizuar ajo ka prodhuar efektin juridik të paraparë me nenin 66b, paragrafi 1 të Ligjit mbi Transferimin e Tokës dhe Ndërtesave – *shuarjen e të drejtës private pronësore në ngastrën kadastrale nr.918 me transferimin e saj në pronësi shoqërore*. Baza ligjore për këtë transformim, siç thuhet në mënyrë eksplicite në Nenin 66b, paragrafi 2 i Ligjit mbi Transferimin e Tokës dhe Ndërtesave, është deklarimi i njëanshëm për heqje dorë nga ISLAM ISLAMI. Në të kundërtën, as përfundimi i një kontrate me komunitetin shoqërore-politik e as nxjerrja e vendimit të autoritetit publik nuk kërkohet normativisht për transformimin e pronësisë private në atë shoqërore sipas nenit 66b të Ligjit mbi Transferimin e Tokës dhe Ndërtesave. Në pajtim me dispozitën e njëjtë në procesverbalin nr.03-2776/1, të përpiluar me 1 mars 1963 në Sektorin për Marrëdhënie Pronësore të Paluajtshme të Këshillit Popullor të Komunës së GJILANIT, është regjistruar një deklaratë eksplicite e ISLAM ISLAMIT i cili heq dorë në favor të Komunës së GJILANIT të drejtat pronësore mbi ngastrën

kadastrale nr.918, të regjistruar në Listën Poseduese nr.1755. Kështu që shtrirja objektive e heqjes dorë sipas nenit 66b të Ligjit mbi Transferimin e Tokës dhe Ndërtesave është përcaktuar *duke iu referuar regjistrimit kadastral* të kësaj prone të paluajtshme si ngastër kadastrale nr.918, e cila gjindet në vendin e quajtur “POPOVICA”, me kulture – tokë e punueshme, klasa e 4-të, me sipërfaqe prej 00.32.20 ha (3 220 m²). Pasi që pranimi i saj nga bashkësia shoqërore nuk është kërkuar nga Ligji mbi Transferimin e Tokës dhe Ndërtesave në asnjë formë, vendimi nr.01-2776/2 i Këshillit Popullor të Komunës së GJILANIT, i datës 10 maj 1963 *nuk ka pasur asnjë efekt themelor ligjor për transformimin e pronës private të ngastrës kadastrale nr.918 në pronësi shoqërore*. Për këtë arsye nxjerrja e tij për pranimin e ngastrave kadastrale nr.917 dhe nr.918, për gjysmën e sipërfaqes së përgjithshme 00.39.24 ha (3 924 m²), që së bashku bëjnë 00.19.50 ha (1 950 m²), *nuk e ka ndikuar vlefshmërinë e deklarimit të mëparshëm të ISLAM ISLAMIT të bërë me 1 mars 1963 për heqjen dorë nga e drejta e tij pronësore në ngastrën kadastrale nr.918, e regjistruar në Listën Poseduese nr.1755, me sipërfaqe prej 00.32.20 ha (3 220 m²)*. Së pari, Vendimi nr.01-2776/2 i Këshillit Popullor të Komunës së GJILANIT, të datës 10 maj 1963 *tejkalon* shtrirjen e deklaratës së ISLAM ISLAMIT të regjistruar në procesverbalin nr.03-2776/1, të datës 1 mars 1963 vetëm për *ngastrën kadastrale nr.917*, e cila nuk është e kontestuar në këtë lëndë, dhe *vice versa* përkon për *ngastrën kadastrale nr.918*, e cila është e kontestueshme. Së dyti, transformimi i pasurisë së paluajtshme të kontestuar nga private në pronësi shoqërore rezulton nga deklarimi i njëanshëm i ISLAM DAUT ISLAMIT sipas nenit 66b të Ligjit mbi Transferimin e Tokës dhe Ndërtesave, në të cilin *në mënyrë të saktë përcaktohet si ngastër kadastrale nr.918 më përshkrim që i përgjigjet atij sipas regjistrimit kadastral*. Kështu që, heqja dorë nuk është e anulueshme për shkak të objektit të pamundshëm, të paligjshëm, të paspecifikuar apo të papërcaktuar. Duke u deklaruar për tokën bujqësore që ka ekzistuar si një njësi kadastrale, e specifikuar si e regjistruar, *heqja dorë është e vlefshme duke e pasur objektin e mundshëm, të lejueshëm, konkret dhe të përcaktueshëm*. Si i tillë ai ka prodhuar pasojat ligjore që parashihen me nenin 66b të Ligjit mbi Transferimin e Tokës dhe Ndërtesave – *prishjen e pronës private në ngastrën kadastrale nr.918 dhe shndërrimin e saj në pronësi shoqërore*. Së treti, Regjistri i Listave Poseduese (1962), ekspertiza gjeodezike e përmendur më lart dhe Lista Poseduese nr.1750, e datës 8 mars 1963 *në mënyrë indirekte* dëshmojnë heqjen dorë të ½ pjesë ideale të RAHIM MUHARREM NIMANIT nga ngastra kadastrale nr.918 në fund të 1962. Ajo ishte regjistruar si ndryshim me nr. rendor nr.218/1962, pas së cilës kjo pronë e paluajtshme ishte transferuar nga Lista Poseduese nr.1755 në Listën Poseduese nr.1750, si pronë shoqërore e Komunës së GJILANIT për ½ pjesë ideale dhe e ISLAM DAUT ISLAMI për ½ pjesë ideale. Sidoqoftë, kjo shkresë si pjesë e shënimeve të DGJKP është tërhequr (marrur) nga autoritetet serbe në 1999 dhe për momentin nuk gjindet në arkivin kadastral, gjyqësor apo në arkivin e përgjithshëm të GJILANIT. Nën këto rrethana transferimi i ½ pjesë ideale të të drejtës pronësore të RAHIM MUHARREM NIMANIT në ngastrën kadastrale nr.918 në

përfitim të bashkësisë shoqërore duhet të konsiderohet si e dëshmuar me anë të Listës Poseduese nr.1750 të DGJKP-GJILAN, të datës 2 tetor 2002 dhe 17 shkurt 2003 dhe Certifikatës nr.P-70403013-00918-0 të DGJKP-GJILAN, të datës 20 prill 2010 dhe 25 gusht 2011, të cilat si dokumente publike sipas nenit 329, paragrafi 1 LPK me efekt të detyrueshëm të dëshmueshëm dëshmojnë *themelimin e pronësisë shoqërore në tërë ngastrën kadastrale nr.918. Së pesti*, të gjitha argumentet e thirrura për mosekzistimin e saj nga ILMI BRAHIMI në padi dhe gjatë seancave janë të pabazuara. Në kundërshtim me nenin 319, paragrafin 1 të LPK-së, pretendimet e tija se regjistrimi i ngastrës kadastrale nr.918 si pronë shoqërore ishte bazuar në fotografimin ajror me rastin e deshifrimit të ngastrave janë të pabazuara. As mungesa e planit zhvillimor specifik urban/hapësinor dhe rregullorja për pronat e paluajtshme të kontestuara sipas Ligjit Nr. 2003/14 të Planifikimit Hapësinor, e as mos-shfrytëzimi i saj për ndërtim apo nevoja të tjera publike nuk e përjashtojnë statusin e saj pronësor si pronësi shoqërore. Kërkesat e nenit 4, paragrafi 1 i LMThPJ për realizimin e të drejtës pronësore në pajtim me natyrën dhe qëllimin e objektit dhe interesi publik siç është i definuar me ligj nuk mundet të barazohet me përdorimin e detyrueshëm. Në pajtim me Nenin 3, paragrafi 1 LMThPJ pronari ka të *drejtë* të posedojë këtë objekt, ta shfrytëzojë dhe të heq dorë nga ajo. Pasi që kjo nuk është e obligueshme, *mosushtrimi i pronësisë në ngastrën kadastrale nr.918 nuk mundet të rezultojë në heqjen dorë nga ajo sipas neneve 44-48 LMThPJ*. Kështu që, është jo relevant fakti se Komuna e GJILANIT nuk ka hyrë në posedim të kësaj prone të paluajtshme –sipas nenit 34, paragrafi 1 LMThPJ *dorëzimi i saj është parakusht për përvetësimin e pronës private dhe vice versa jo për ato publike*. Kjo është arsyeja pse *dorëzimi i papërfunduar* i ngastrës kadastrale nr.918 në Komunën e GJILANIT nuk e përjashton përvetësimin e pronës shoqërore në të pasi që regjistrimi kadastral e plotëson këtë rezultat - neni 33 *LMThPJ*. Sa për *mos-posedimin* e kësaj prone të paluajtshme nga Komuna e GJILANIT, kjo nuk mundet të përfaqësojë *braktisje* sipas nenit 46, paragrafi 1 *LMThPJ* – kjo prishje e të drejtave pronësore për të provuar nenin 46, paragrafin 3 *LMThPJ* nuk është e aplikueshme për *pronat publike të paluajtshme*. Poashtu i pabazuar është edhe argumenti në padi se *duke qenë i rrethuar vetëm nga pronat private të paluajtshme, ngastra kadastrale nr.918 nuk mundet të jetë pronë shoqërore*- pa marrë paraqysh vendin në njërën apo në të njëjtën zonë dhe vend si dhe fqinjësinë, *ato përfaqësojnë objekte të ndara të të drejtave pronësore, të pavarura si gjendje e pronësisë*. Duke përfunduar, pas transformimit të pronësisë private të ngastrës kadastrale nr.918 sipas nenit 66b të Ligjit mbi Transferimin e Tokës dhe Ndërtesave që nga viti 1963 ajo ka qenë në pronësi shoqërore. Në pajtim me nenin 29 LMThPJ *si një objekt nën pronësi publike ajo nuk mundet të fitohet nëpërmjet parashkrimit fitues*. Ky ndalim në mënyrë të domosdoshme është i definuar pa asnjë përjashtim, duke përfshirë ato të bazuara në kufijtë e ngastrës kadastrale nr.918 me ngastrën kadastrale nr.920/2 e blerë nga ILMI BRAHIMI në shkurt 1981. Mos njohuria e tij për regjistrimin e ngastrës kadastrale të kontestuar ne emër të Komunës së GJILANIT, si dhe posedimi i saj pa pengim dhe ndërprerje për më shumë se 20 vite

nuk e derogon ndalimin sipas nenit 29 LMThPJ që përjashton aplikimin e nenit 28 LMThPJ në të gjitha shpjegimet e tij. Si pasojë kultivimi i pjesës pjellore të ngastrës kadastrale nr.918 nga ILMI BRAHIMI nga qershori 1981 deri në gusht 2009 është *faktikisht posedimi i ushtruar, pa efekt juridik për përvetësimin e saj sipas nenit 21 LMThPJ i cili është i pakushtëzuar dhe domosdoshmërisht i përjashtuar me nenin 29 LMThPJ për të gjitha objektet nën pronësi shoqërore*. Në lidhje me posedimin e tij pas shfuqizimit të nenit 29 LMThPJ me Nenin 296 të Ligjit No.03/L-054 mbi Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore (LPDS) me 29 gusht 2009, ajo është pa kohëzgjatje minimale prej 20 viteve siç kërkohet me Nenin 40, paragrafin 1 LPDS pas asaj date pa asnjë retroaktivitet për posedimin e akumuluar para saj. Për këtë arsye për periudhën 1981– 2009 *ngastra kadastrale nr.918 duke qenë një objekt nën pronësi shoqërore nuk mundet të përfitohet nëpërmjet përshkrimit pozitiv sipas nenit 29 LMThPJ, kurse për periudhën 2009 – 2011 posedimi i saj është pa kohëzgjatjen prej 20 viteve të kërkuar me nenin 40, paragrafin 1 të LPDS*.

26. Pas kësaj analize, përfundimi i gjykatës së shkallës së dytë është se ILMI BRAHIMI sipas nenit 319, paragrafi 1 dhe nenit 322, paragrafi 2 LPK si palë që bartë peshën ekluzive të dëshmimit të të gjitha fakteve për ekzistimin e të drejtës së pronësisë në pronën e paluajtshme të kontestuar *ka dështuar të dëshmojë se ai ka fituar në ndonjërin nga bazat alternative për përvetësimin e saj – me vet ligjin, transaksionin ligjor të vlefshëm pa pronar të mëparshëm, i regjistruar në librat kadastral, trashëgimi apo vendim nga autoriteti kompetent qeveritar*. Pasi që legjitimiteti i tij aktiv si pronar nuk është vendosur, gjykata e shkallës së parë duke vepruar në pajtim me Nenin 322, paragrafin 1 të LPK-së ka aplikuar rregullat e barrës së provës sipas Nenit 319, paragrafin 1 dhe Nenin 322, paragrafin 2 LPK dhe ka refuzuar vërtetimin e pronësisë së pretenduar në ngastrën kadastrale nr.918 si jo-ekzistuese, *pa aplikim të gabueshëm të ligjit substancial sipas nenit 184 LPK*.

VI. Përfundim

27. Duke u bazuar në faktet e përmendura më lart, gjykata e shkallës së dytë refuzon ankesën e ILMI BRAHIMIT si të pabazuar dhe vërteton aktgjykimin C.nr.559/02 e Gjykatës Komonale të GJILANIT të datës 6 tetor 2010 në pajtim me nenin 195, paragrafin 1, pika d) në lidhje me nenin 200 të LPK-së. Ky aktgjykim është nxjerrur ligjërisht pa baza për ankimim sipas nenit 181, paragrafi 1, pikat a) – c) LPK të thirrur në ankesë apo të tjera të identifikuara *ex officio* në këto procedura të shkallës së dytë në lidhje me refuzimin e padisë sipas Nenit 254, paragrafi 1 LPK apo përgjegjësinë për shpenzime procedurale sipas Nenit 452, paragrafi 2 LPK.


Në lidhje me arsyetimin e përmendur më lart është vendosur si në dispozitiv.

MJETI JURIDIK: Asnjë mjet juridik nuk lejohet kundër këtij aktgjykimi.

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT

AC.nr.35/2011 me 30.09.2011

KRYETARE E TRUPIT GJYKUES



ROSITZA BUZOVA

Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRĐUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

**Përkthyer nga anglishtja ne shqip nga:
DAUT LATIFAJ, perkthyes ne EULEX,**

Përgatitur në Gj. Angleze si gjuhë zyrtare, në përputhje me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

NJOFTIM MBI KËSHILLIM DHE VOTIM

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT, në kolegjin gjyqësor të përbërë nga Gjyqtarja Civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA, si kryetare e kolegjit, gjyqtari vendor MUHAMET REXHA dhe gjyqtari vendor ABDULLAH AHMETI, si anëtarë të kolegjit, **me 30 shtator 2011 diskutuan dhe votuan unanimitisht si në dispozitivin e këtij aktvendimi.**

Ky njoftim i bashkëngjitet Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT AC. nr.35/2011, të datës 30 shtator 2011 në pajtim me nenin 140 , paragrafi 1, fjalia e dytë e LPK-së.

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT

AC.nr.35/2011 me 30.09.2011

ROSITZA BUZOVA

Kryetare e trupit gjykues

MUHAMET REXHA

Anëtari i trupit gjykues

ABDULLAH AHMETI

Anëtari i trupit gjykues

HENRIK BARRDAHL

Zyrtar ligjor i EULEX-it

DAUT LATIFAJ

Përkthyes (Anglisht/shqip)

Përkthyer nga anglishtja ne shqip nga:

DAUT LATIFAJ, përkthyes ne EULEX,

Përgatitur në Gj. Angleze si gjuhë zyrtare, në përputhje me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe e nënshkruar nga gjyqtarët vendor pas përkthimit të bërë nga përkthyesja e cekur më lart.